

Ma
Dana

23-03-2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi si dhe me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga [REDACTED], për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II nr.2447-1/2016 të datës 14.04.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Albert Zejnnullahu, të pandehurit [REDACTED] si dhe përkthyesit zyrtar shqipserbisht Mentor Zejna, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me date 10.01.2018 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 19.01.2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

Të akuzuarin: [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në rrugën "[REDACTED]" nr. [REDACTED] në [REDACTED], me profesion autolimar, ka të kryer shkollën e mesme, student, i gjendjes së mesme ekonomike, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal [REDACTED].

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 02.12.2016, rreth orës 00:00, në rrugën "Tahir Sinani" në Shtime, i pandehuri me qëllim përdorimi, pa autorizim ka poseduar substanca narkotike, ashtu që derisa i njëjti ishte duke lëvizur me veturën e tij të tipit "Passat", ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit [REDACTED], është ndalur nga një njësi patrulluese e policisë dhe gjatë kontrollit i është gjetur një cigare me substance narkotike të llojit kanabis (Marihuane), me peshe 0.58 gram, e cila sasi pas identifikimit nga policia është sekuestruar.

me të cilën ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 41, 46, dhe 73 e 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit [REDAKTUAR], e

G J Y K O N

- **DËNIM ME GJOBË**, në shumë prej 300 Euro /treqind/, të cilin gjobë është i obliguar ta paguani në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Në rast se të pandehurit nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.
- Ne baze te nenit 275 par. 3 konfiskohen në mënyrë të substancat narkotike me pash neto 0.58 gram.
- I pandehuri obligohen që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 40 € /katër dhjetë/, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2447-1/2016 te dt. 14.04.2017, ka ngarkuar të akuzuarit [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-së, më

tutje prokurori i shtetit pas leximit te aktakuzës shtone se bazuar ne provat materiale siç është raporti i forenzikes, fotografit e bëra nga vendi i ngjarjes bënë ricilsimin e veprës penale nga paragrafi 1 ne paragrafin 2 te neni 275 te KPRK-se, me qe është ne favor të të pandehurit dhe ligji këtë ja garanton andaj, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues te ricilsuar, duke propozuar që te pandehurin ta shpalle fajtor dhe te i shqiptohet nje sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.00.2018, në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari [REDAKTUAR] është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza sipas te gjitha pikave, është i vetdishem për pranimin e fajësisë dhe pasojat qe mund te vijne nga ky pranim, i vjen keqe për këtë vepër penale, është hera e pare qe ndeshet me ligjin dhe lut gjykatën te i shqiptoj një dënim sa me te but.*

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që të akuzuari kanë pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësore, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysht edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

-
- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajtit;
 - pranimi është bërë vullnetarisht;
 - pranimi i fajtit mbështet në faktet dhe prova materiale të rasti konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarve ne shqyrtimin fillestar, raporti i ekspertimit i Agjencise te Kosovës për Foreznike me numër AKF/2017-0168/2017-158 i datës 17.03.2017, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve te datës 14.12.2016, fotografitë, si dhe provat tjera te cilat gjenden ne shkresat e lendes si dhe deklaratat e të pandehurit;
 - si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

 - me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj trupi gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPP-

së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, (nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim fillestar publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim të diapozitivit të aktgjykimit: Se me datën 02.12.2016, rreth orës 00:00, në rrugën "Tahir Sinani" në Shtime, i pandehuri me qëllim përdorimi, pa autorizim ka poseduar substanca narkotike, ashtu që derisa i njëjti ishte duke lëvizur me veturën e tij të tipit "Passat", ngjyrë e zeze, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], është ndaluar nga një njësi patrulluese e policisë dhe gjate kontrollit i është gjetur një cigare me substance narkotike të llojit kanabis (Marihuane), me peshe 0.58 gram, e cila sasi pas identifikimit nga policia është sekuestruar.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për veprën penale përdorimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 të KPRK-së, të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin I dhe II këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata ndaj të akuzuarve si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë, rrethana lehtësuese i morri premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëritin vepra penale, nuk ka dëshmi se vërteton që është gjykuar me vendim të formës së prerë, ndërsa në mungesë në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese Gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Ne baze të nenit 275 paragrafi 3 të konfiskohen në mënyrë të përhershme substancat narkotike e llojit marihuan në peshe neto 0.58 gram.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësore të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 40 € /katër dhjetë/, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P nr.995/2017, me datë 19.01.2018

Zyrtare ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI

F. Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.